



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH**

Nr. 171/2 prot

Gramsh, më 05/01/2021

Vendim

Nr. 03, dt. 29.01.2021

Për miratimin e kërkesës të familjes Orgest Sefer Brami që tërhiqet nga subvencionimi i interesave të kredisë me interes të ulët (blerje banesa në tregun e lirë), duke pritur të miratohen në një program tjetër social, që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh.

Këshilli i bashkisë Gramsh, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje, transporteve, strehimit dhe emergjencat civile, "Për miratimin e kërkesës të familjes Orgest Sefer Brami që tërhiqet nga subvencionimi e interesave të kredisë me interes të ulët (blerje banesa në tregun e lirë), duke pritur të miratohen në një program tjetër social, që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh", bazuar në ligjin nr.22/2018, "Për strehimin social", neni 11, pika 3, të VKM nr.334, dt.12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", të VKM nr. 453, dt.03.07.2019, "Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti", pika 24,25si dhe ,të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2, neni 64;

Vendos:

- I. Miratimin e kërkesës të familjes Orgest Sefer Brami që tërhiqet nga subvencionimi e interesave të kredisë me interes të ulët (blerje banesa në tregun e lirë).
 - II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë dhe drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje, transporteve, strehimit dhe emergjencave civile.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kon.Xh.Gjini
Pranoi: G.Lena
Miratoi: G.Lena
Dosja nr. _____
Afati _____

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Xhulia GJINI

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Greta LENA

